“Allahu i Lartmadhëruar ju ndalon të betoheni në baballarët tuaj

Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu i Lartmadhëruar ju ndalon të betoheni në baballarët tuaj.” Omeri shton: "Për Allahun, qëkurse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke e ndaluar atë, as vetë nuk jam betuar (në prindër) e as e kam cituar betimin e tjetërkujt (në prindër)."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se Allahu i Lartësuar ndalon të betohemi në baballarët, kështu që, kushdo që dëshiron të betohet, le të betohet vetëm në Allahun dhe të mos betohet në askënd tjetër. Pastaj Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përmendi se nuk ishte betuar qëkurse e kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke e ndaluar një gjë të tillë, as qëllimisht e as duke e përmendur betimin e dikujt tjetër që është betuar në dikë tjetër përveç Allahut.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/2945